



A.L.T.R.I

**RAPORTI PËR
SITUATËN E TRAFIKIMIT
TË QENIEVE NJERËZORE
NË SHQIPËRI
GJATË PERIUDHËS
SË PANDEMISË COVID-19**





Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

In cooperation with



RAPORTI PËR SITUATËN E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE NË SHQIPËRI GJATË PERIUDHËS SË PANDEMISË COVID-19

Ky publikim është mbështetur nga Projekti Rajonal për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin e Ekonomik (BMZ) dhe zbatuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ). Përmbajtja e këtij publikimi përfaqëson mendimin e ekspertëve të Qendrës A.L.T.R.I. dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ).

Dhjetor 2020

Tabela e Përmbajtjes

RRETH PROJEKTIT	3
KAPITULI I. ANALIZA E PARASHIKIMEVE LIGJORE NË NIVEL NDËRKOMBËTAR DHE KOMBËTAR.....	5
KAPITULLI II. RAPORTE MBI SHËRBIMET ADMINISTRATIVE QË NDIKOJNË NË TRAJTIMIN E QENIEVE TË TRAFIKUARA GJATË PERIUdhËS SË PANDEMISË NË SHQIPËRI	6
KAPITULLI III. SITUATA AKTUALE E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT NË SHQIPËRI	9
KAPITULLI IV. PROBLEMATIKAT E EVIDENTUARA NGA ANKETIMI ME VIKTIMAT E TRAFIKIMIT PRANË QENDRAVE TË AKOMODIMIT TË TYRE DHE REKOMANDIMET PËRKATËSE.....	10
REKOMANDIME.....	12

Rreth projektit

Trafikimi i qenieve njerëzore zakonisht i referohet procesit përmes të cilit individët vendosen ose mbahen në një situatë shfrytëzuese për përfitime ekonomike. Përpjekjet ndërkombëtare për të adresuar këtë fenomen mund të gjurmohen që nga shekulli i nëntëmbëdhjetë. Sidoqoftë, vetëm gjatë dy dekadave të fundit është zhvilluar një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse rreth çështjes. Pavarësisht nga ekzistenca e një kornize gjithëpërfshirëse ligjore ndërkombëtare, miliona fëmijë, gra dhe burra vazhdojnë të trafikohen çdo vit, në të gjitha rajonet dhe në shumicën e vendeve të botës. Viktimat mund të trafikohen brenda një vendi ose përtej një kufiri për qëllime të ndryshme, duke përfshirë punën e detyruar dhe shfrytëzuese në fabrika, ferma dhe shtëpi private, shfrytëzim seksual, martesë të detyruar dhe heqjen e organeve. Natyra klandestine e trafikimit e bën të vështirë vlerësimin e fenomenit. Bazuar nga studimet dhe raportet e hartuara për fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore, cilësohet se vendet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë të gjitha kapacitetet e duhura për të parandaluar këtë fenomen. Dy arsyt kryesore janë individët që jetojnë në këto vende kryesisht emigrojnë drejt shteteve të Bashkimit Europian (BE) dhe ndërkohë individë që jetojnë në vendet e treta, hyjnë në Ballkanin Perëndimor me qëllim kalimin në BE. Një faktor që rëndon akoma më shumë situatën, është dhe pandemia e cila ka ndryshuar ekuilibrat duke ndikuar drejtpërdrejt në aspektet ekonomike, infrastrukturore, politike etj. Një sërë segmentesh në Shqipëri janë prekur si rezultat i pandemisë COVID-19, por kryesisht vlen të theksohet se kjo pandemi ka prekur grupet në nevojë si: njerëzit në varfëri ekstreme, personat e moshuar, individë të papunë, persona me aftësi të kufizuara, gra dhe vajza, të rinj refugjatë, emigrantë dhe grupet minoritare.

Duke iu referuar studimeve dhe raporteve të ndryshme të kryera, Shqipëria, pavarësisht nga të gjitha përpjekjet e bëra, vazhdon të jetë një vendburim për burra, gra dhe fëmijë që i nënshtrohen trafikimit të personave, veçanërisht prostitucion të detyruar dhe punë të detyruar, duke përfshirë lypjen e detyruar të fëmijëve. Faktorët kryesorë të identifikuar si tregues që favorizojnë trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, duke specifikuar trafikimin e grave, fëmijëve dhe anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian janë: (1) Situata e vështirë dhe kushtet e pafavorshme socio-ekonomike; (2) Dhuna në familje; (3) Rekrutimi i fëmijëve nga të afërmit për “lypje”, ose punë të detyruar.

Qendra ALTRI me mbështetjen e Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar GIZ, ka ndërmarrë iniciativën “Masat për parandalimin për trafikimin e qenieve njerëzore si dhe parandalimin e përhapjes së COVID-19 në strehëzat ku strehohen viktimat dhe viktimat potenciale të trafikimit”. Projekti është i ndarë në dy komponente dhe ka për qëllim garantimin e të drejtave të viktimave të trafikimit si dhe parandalimin e përhapjes së COVID-19 brenda strehëzave në të cilat janë të strehuara kjo kategori përfituese. Gjithashtu, projekti synon të kontribuojë në nismën e propozuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) për të forcuar mirëqenien dhe qëndrueshmërinë e viktimave (potenciale) duke fuqizuar autoritetet publike dhe organizatat e shoqërisë civile për të kryer fushata ndërgjegjësimit tek grupet e synuara. Në përmbushje të komponentit të parë, Qendra ALTRI ka hartuar “Raportin për situatën e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri gjatë periudhës së pandemisë COVID-19”. Qëllimi i këtij raporti, është që përmes evidentimit të problematikave që përballen viktimat e trafikimit gjatë periudhës së pandemisë, të merren hapat e duhur nga Shqipëria në luftimin e këtij fenomeni, duke përfshirë edhe problematikave që janë konstatuar gjatë kësaj periudhe. Raporti paraqet kuadrin ligjor, raportet, analizat, situatën dhe rekomandimet, në lidhje me Viktimat e Trafikimit (VT)/ Viktimat e Mundshme të Trafikimit (VMT). Raporti fokusohet tek gjendja aktuale e viktimave të trafikimit, efikasiteti i autoriteteve ligj-zbatuese në zbatimin e ligjit dhe përmirësimin e situatës së viktimave të trafikimit që ndodhen në qendrat e pritjes apo strehimit, gjatë periudhës së pandemisë.

Kapituli I.

Analiza e parashikimeve ligjore në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar

Republika e Shqipërisë ka nënshkruar dhe ratifikuar disa Konventa Ndërkombëtare si Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional, si dhe dy Protokollin e saj shtesë, “Protokollin e Palermos” dhe “Protokollin e Emigrantëve”, të cilët parashikojnë krahas masave të shtuara në parandalimin dhe ndëshkimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe garancitë për trajtimin e tyre me shërbime të ofruara nga organet shtetërore. Në fokus të veçantë të këtyre akteve ndërkombëtare janë dhe trajtimi dhe parandalimi i trafikimit të grave, fëmijëve dhe grupeve vulnerabel nëpërmjet rrugëve ajrore, tokësore apo detare. Konform parashikimeve të konventave në të cilat Shqipëria ka aderuar, krahas masave me aspekt penal, janë ndërmarrë ndryshime ligjore edhe në fushën sociale, të shërbimeve administrative, të punësimit, trajtimit dhe standardeve të kësaj kategorie personash në qendrat pritëse.

Shqipëria ka ratifikuar me ligj Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijëve, në të cilën kërkohet që në raste të veçanta, fëmijët duhet të ri-integrohen nga trauma në trafikimit me anë të mjediseve dhe programeve të veçanta. Nga të dhënat rezulton se burimet dhe infrastruktura institucionale që ofron shteti shqiptar, për kategorinë e fëmijëve si viktima të trafikimit, veçanërisht për ata të pashoqëruar, nuk është ende në nivelin e kërkuar si dhe nuk ka ende një institucion të veçantë shtetëror që të ofrojë të gjitha shërbimet psiko-sociale dhe edukative të posaçme ndaj tyre.

Lidhur me situatën e pandemisë, si një lloj regjimi i veçantë që kërkon përgjigje adekuate nga organet shtetërore, Konventa e OKB parashikon si detyrim për shtetet palë që në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore. Shtetet palë sigurojnë gjithashtu se institucionet, shërbimet dhe qendrat përgjegjëse për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e shëndetit, të numrit dhe të aftësive të personelit të tyre si dhe të mbikëqyrjes së duhur.

Sipas Konventës së OKB, shtetet palë njohin funksionin e rëndësishëm që përmbushin mjetet e komunikimit masiv dhe sigurojnë që fëmija të marrë informacione dhe materiale që vijnë nga burime të ndryshme kombëtare, sidomos ato që synojnë të rrisin mirëqenien e tij shoqërore, shpirtërore e morale, si dhe shëndetin e tij fizik dhe mendor. Në këtë rast, përfshihen edhe komunikimet *online*, të cilat gjatë periudhës së pandemisë apo kufizimit të shërbimeve administrative duhet të jenë të garantuara.

Të gjitha detyrimet e mësipërme të konventës janë shumë të rëndësishme, veçanërisht kur ato trajtohen gjatë situatës së pandemisë dhe në përballimin e nevojave të tyre në këtë periudhë, ndaj parashihen si dispozita që duhet të referohen dhe mbahen në konsideratë për një trajtim sa më të mirë në zbatim të standardeve ndërkombëtare.

Një aspekt i veçantë që ndikon në efikasitetin e zbatimit të Konventës të Këshillit të Europës për Masat Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, është edhe krijimi i Mekanizmit Monitorues, i cili përbëhet nga një grup ekspertësh që vëzhgojnë mënyrën e zbatimit të Konventës, *duke raportuar periodikisht mënyrën e zbatimit të këtij akti ndërkombëtar nga shtetet anëtare, duke përdorur si protokoll mbikëqyrje, anketimet drejtuar shteteve anëtare, vizitave monitoruese dhe hetimet konkrete për raste të veçanta.*

Konventa, lidhur me zbatimin e garancive dhe standardeve gjatë periudhës së pandemisë, parashikon midis të tjerash se shtetet duhet të miratojnë masa legislative ose administrative që mund të jenë të nevojshme për të ndihmuar viktimat në rimëkëmbjen e tyre fizike, psikologjike dhe sociale. Një ndihmë e tillë duhet të përfshijë një standard jetese të përshtatshëm për të siguruar jetesën e tyre, përmes masave të tilla si akomodimi i duhur dhe i sigurt, ndihma psikologjike dhe materiale, qasje në trajtim mjekësor, këshillim dhe informacion, veçanërisht në lidhje me të drejtat e tyre ligjore.

Krahas të drejtave të lartpërmendura, Konventa trajton edhe kujdesin që duhet treguar për të ofruar ndihmën e duhur që të drejtat dhe interesat e personave të trafikuar, veçanërisht grave dhe fëmijëve të garantohen në çdo fazë. Me rëndësi të veçantë mbetet aksesin i fëmijëve në arsim, garantimi i nevojave të viktimës për siguri dhe mbrojtje, ndihma e nevojshme mjekësore ose dhënia e një ndihme tjetër për viktimat në mënyrë të ligjshme në çdo territor apo ambient. Kjo për rastet kur nuk kanë burime të përshtatshme dhe kanë nevojë për ndihmë institucionale, për të përfituar veçanërisht nga tregu i punës dhe formimi profesional ose arsimor.

Kapitulli II.

Raporte mbi shërbimet administrative që ndikojnë në trajtimin e qenieve të trafikuar gjatë periudhës së pandemisë në Shqipëri

Organizata Ndërkombëtare e Punës¹ vlerëson se kufizimet për shkak të pandemisë gjatë vitit 2020 kanë prekur një numër marramendës prej 2.7 miliardë punonjësish ose 81% (për qind) të fuqisë punëtore në botë. Në kulmin e bllokimeve në Prill 2020, sipas Organizatës Arsimore, Shkencore dhe Kulturore të OKB, mbylljet e shkollave në 194 vende prekën 90% (për qind) të studentëve të botës në nivelet e arsimit parafillor, fillor, të mesëm dhe të lartë.

Duke pasur parasysh vështirësitë e mëdha financiare për familjet, lëvizjen masive të njerëzve dhe mbylljen e shkollave, trafikimi i qenieve njerëzore mund të lulëzojë më shumë në këtë mjedis aktual, ndaj kërkohen nisma shtetërore dhe civile me impakt të konsiderueshëm. Në këtë kontekst global, situata e Shqipërisë merr një rëndësi specifike, duke parë raportimet dhe anketimet që administrohen nga situata aktuale social-ekonomike e personave të trafikuar dhe mbështetja e shërbimeve shëndetësore ndaj tyre.

Sipas ILO, statistikat e mëparshme për trafikimin e qenieve njerëzore paraqesin të dhëna të cilat tregojnë se gjatë periudhave të epidemive masive të mëparshme, shkalla e trafikimit të qenieve njerëzore është rritur në mënyrë të konsiderueshme, si pasojë e numrit të vdekjeve të prindërve duke i lënë fëmijët jetim në rrezik të trafikimit nga grupet kriminale, siç evidentohet në rastin e përhapjes së virusit EBOLA.

Çështja e trafikut të qenieve njerëzore është trajtuar si pjesë mjaft e rëndësishme në Progres Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë², ku disa prej rekomandimeve kanë qenë më tepër të fokusuar tek masat dhe ofrimi i zgjidhjeve nga institucionet publike, të cilat kanë si detyra funksionale jo vetëm luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore po ashtu edhe identifikimin dhe ri-integrimin ekonomik dhe social të viktimave të trafikimit.

1 Raporti i ILO "Organizatës Ndërkombëtare të Punës" mbi efektet globale të pandemisë për punësimin: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/@dgreports/@dcomm/documents/briefingnote/wcms_740877.pdf

2 Politikat e zgjerimit të Bashkimit Evropian; https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis_en

Komisioni Evropian, duke e konsideruar Shqipërinë si një vend origjine dhe transiti të trafikimit, ka kërkuar buxhetimin institucional të Koordinatorit Kombëtar kundër Trafikimit dhe forcimit të rolit vendimmarrës të Mekanizmit Kombëtar të Referimit.

Po ashtu këto fonde duhet të jenë të fokusuar për të forcuar qendrat e pritjes dhe shërbimet që duhet t'ju ofrohen personave të akomoduar, në bashkëpunim me shoqërinë civile. Në raportet e Komisionit Evropian theksohet nevoja e forcimit të këtij bashkëpunimi për të intensifikuar përpjekjet për pritjen dhe trajtimin sipas standardeve të viktimave të trafikimit. Çështja e trajtimit të fëmijëve si viktima të trafikimit ka qenë një problematikë që vijon të shoqërojë sfidat aktuale në luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore në vendin tonë.

Komisioni Evropian ka ngritur shqetësimin se Shqipëria nuk ofron ende mundësinë për hapjen e qendrave ose ambienteve të veçanta për trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar të përfshirë në trafikim. Institucionet shqiptare që mbulojnë fushën e trafikimit, nuk kanë ende një studim të publikuar deri më sot, në të cilin të llogariten hapësirat jetike optimale për strehimin e viktimave të trafikimit, dhe norma e mbipopullimit të ambienteve të ofruara. Referuar situatës së pandemisë, ky konstatim merr shumë rëndësi dhe duhet trajtuar në mënyrë prioritare për të zbatuar protokollin e mbrojtjes mjekësore në qendrat pritëse. Po ashtu, në këtë kuadër Komisioni Evropian ka konstatuar një mungesë në parashikimin e flukseve vjetore të viktimave të trafikimit në raport me infrastrukturën që ofrohet nga shtëpitë e pritjes, duke i mbingarkuar këto qendra me mbipopullim dhe me mungesë të shërbimeve standarde në trajtimin e viktimave të trafikimit.

Në një raportim special të Kombeve të Bashkuara³ mbi situatën e trafikimit gjatë pandemisë janë rekomanduar disa masa, të cilat duhet të ndiqen për zbatim nga shtetet ku bën pjesë edhe Shqipëria me qëllim për të minimizuar efektet negative të kësaj situatë ndaj qenieve njerëzore të rrezikuara siç janë dhe viktimat e trafikimit.

Masat e sugjeruara janë të lidhura me sigurimin e mbështetjeve të menjëhershme për popullatat më të prekura, në veçanti të punonjësve informalë, për të cilët duhet të aktivizohen stimujt fiskalë dhe material. Po ashtu duhen mbështetur këto kategori me skema të mbështetjes së pagave, të cilat do të parandalonin ata nga kërkimi i punësimeve të parregullta ose shfrytëzuese nga grupet kriminale.

Rekomandimet e nxjerra nga organet ndërkombëtare, sugjerojnë dhe rritjen e mbikqyrjes nga inspektoriatet përkatëse të punës për evidentimin e rasteve të abuzimit dhe shfrytëzimit të grupeve të marginalizuara për punë të detyruar apo për punësim të parregullt.

Nga raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH), evidentohet se Shqipëria ka bërë progres në alokimin e fondeve apo marrjen e masave konkrete për përmirësimin e infrastrukturës në qendrat e strehimit të viktimave të trafikimit duke bashkëpunuar me OJF-të përkatëse, por si pasojë e moskoordinimit relevant të strukturave të ministrive me organet e tjera shtetërore, këto masa nuk janë të mjaftueshme.

DASH rekomandon përmirësimin e shërbimeve sociale, shëndetësore dhe riintegruese me anë të alokimit të fondeve drejtpërdrejtë tek qendrat që administrohen nga OJF, të përshtatura për pritjen dhe strehimin e viktimave të trafikimit.

3 Raporti i Kombeve të Bashkuara, efektet e pandemisë për personat e trafikuar: <https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Trafficking/COVID-19-Impact-trafficking.pdf>

Ky financim në kushtet e shtimit të nevojave gjatë pandemisë ka krijuar një problematikë, e cila është konstatuar edhe nga anketimet e zhvilluara nga ana e ALTRI, gjë e cila kërkon zgjidhje të shpejtë dhe efçente nga ana e organeve shtetërore në bashkëpunim me OJF-të. Në këtë rast, financimi nuk prek vetëm zëra të plotësimit të nevojave ditore për më shumë konfeksione mbrojtjeje apo dezinfektimi, por për shtim të zërave të tjera specifike, të cilat në kohë pandemie marrin një peshë të konsiderueshme në fushat psiko-sociale dhe shëndetësore.

Sipas raporteve ndërkombëtare, theksohet nevoja e riorganizimit të strukturave ligjzbatuese në kundërpërgjigje të metodave të reja të trafikimit, të zhvilluara nga grupet kriminale, në përshtatje me kushtet dhe kufizimet e ardhura si pasojë e pandemisë COVID-19.

Nga raportimet e GRETA, konstatohet theksimi i problematikës së financimit të vazhdueshëm dhe të programuar për të plotësuar të gjithë nevojat e qendrave pritëse dhe të projekteve të OJF-ve, si dhe punësimi i garantuar apo shkollimi i viktimave të trafikimit, mbeten edhe sot problematika ende të pazgjidhura plotësisht.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me mandatin e tij kushtetues për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve shqiptarë, e ka konsideruar mjaft të rëndësishëm ndjekjen e rasteve të azilkërkuesve, trajtimin e tyre, brenda apo jashtë Shqipërisë, si dhe zbulimin dhe parandalimin e abuzimit me këtë kategori personash. Problematikat e adresuara në këtë rast, kanë qenë të lidhura me fëmijët e pashoqëruar, gratë, të rriturit, komunitetet dhe minoritetet e marginalizuara, pjesëtarët e të cilëve janë më shumë të përfshirë në problemet e kufizimit për shkak të Pandemisë, duke rënë viktimë e trafikimit të paligjshëm dhe shfrytëzimit.

Avokati i Popullit ka ngritur prej disa kohësh problematikat e një kategorie të veçantë viktimash potenciale të trafikimit të qenieve njerëzore, siç janë romët. Kjo kategori futet në tipologjinë e viktimave me risk mjaft të lartë për shkak të një sërë faktorësh social dhe ekonomik, e cila në kohë pandemie ka një problematikë akoma dhe më të mprehtë.

Romët në Shqipëri, sipas Avokatit të Popullit janë në mjaft raste viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe fëmijët rom shpesh herë shfrytëzohen në aktivitetet e lypjes, apo në sektorë të ndryshëm të ekonomisë informale. Megjithë konstatimet e Avokatit të Popullit, aktualisht nuk vërehet që në situatën e pandemisë të jenë shtuar masat monitoruese dhe mbështetëse ndaj kësaj kategorie.

Avokati i Popullit është përpjekur gjithashtu që të ushtrojë veprimtarinë e tij monitoruese edhe në qendrat pritëse të trajtimit të viktimave të trafikimit. Në raportet e tij⁴, evidentohen problematika për sa i përket infrastrukturës së qendrave pritëse të VT/VMT-ve, mungesë e burimeve njerëzore, ku rekomandohet nevoja për shtimin e stafit me kohë të plotë të psikologëve, punonjësve social dhe juristëve, si dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ushqimore për viktimat e trafikimit. Këto konstatime marrin një vëmendje trajtimi dhe urgjence për ndërhyrje veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë, duke kërkuar më shumë fonde dhe burime njerëzore të specializuara.

4 Raport Vjetor i Avokatit të Popullit 2012, Përmirësimi i Shërbimeve fq. 31: <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/RAPORTI%202012.pdf>; <https://avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Rekomandohet%20p%C3%ABrmir%C3%ABsimi%20i%20m%C3%ABtejsh%C3%ABm%20i%20kushteve%20dhe%20i%20trajtimi%20t%C3%AB%20azil>

Në vijim të vizitave në rolin e Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës, Avokati i Popullit ka kryer inspektime⁵ edhe në Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuësve, e cila është e vetmja qendër në territorin e Republikës së Shqipërisë ku akomodohen dhe trajtohen shtetas të huaj që kërkojnë mbrojtje në Shqipëri. Në këtë institucion, ashtu si dhe në rastet e tjera, janë identifikuar problematika mbi normativat për trajtimin e personave që akomodohen, duke mos pasur asnjë normë konkrete. Në rastin e situatës së pandemisë, mungesave të mësipërme, ju shtohen edhe një sërë nevojash të tjera në kuadër të respektimit të protokolleve anti-COVID gjë e cila veshtrëson shumë jetesën e kësaj kategorie personash.

Kapitulli III.

Situata aktuale e viktimave të trafikimit në Shqipëri

Sipas raportimeve të Ministrisë së Brendshme, gjatë vitit 2019 janë evidentuar rreth 100 raste të viktimave të trafikimit, të lidhura kryesisht me trafikimin me qëllim shfrytëzimin seksual, lypësi dhe trafikim të paligjshëm të emigrantëve. Zonat më të prekura nga ky fenomen në Shqipëri evidentohen të jenë: Vlora, Tirana dhe Elbasani. Shifrat e trafikimit vijnë të jenë të njëjta edhe për periudhën e parë të vitit 2020 dhe si faktori kryesor që ndikon në këtë situatë konsiderohen të jenë dhe problematikat socio-ekonomike të shkaktuara si rrjedhojë e pandemisë.

Në përgjigje të situatës së trafikimit, Shqipëria ka krijuar dhe Mekanizmin Kombëtar të Referimit (MKR) për Viktimat dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit. Nga analizat e raporteve rezulton se ky mekanizëm nuk është mbledhur gjatë periudhës së pandemisë për të marrë masa konkrete në përgjigje të situatës së trafikimit dhe marrjes së masave adekuate për përmirësimin e kushteve të viktimave të trafikimit pranë qendrave të tyre të akomodimit.

Nga zbatimi i një projekti nga Swiss Development Cooperation⁶, vërehet se organet e qeverisjes vendore kanë marrë masa të konsiderueshme për t'u përgjigjur ndaj pasojave të pandemisë në nivel vendor, por përsëri konstatohet se këto fonde të shtuara nuk i përgjigjen në mënyrë efikase të gjitha shërbimeve të kërkuara në mënyrë të posaçme për viktimat e trafikimit duke mbuluar shërbime si: *strehim, mbështetje qiraje, aktivitete sociale, këshillime, shërbim shëndetësor dhe psikologjik, arsim dhe trajnime etj.*

Në kuadër të këtyre studimeve, krahas organeve vendore, një detyrë e rëndësishme makro ju përket edhe organeve qendrore shtetërore, sidomos atyre politik-bërëse. “Autoriteti Përgjegjës për Identifikimin, Referimin, Mbrojtjen dhe Ri-integrimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit”, është një institucion që udhëheq zbatimin e MKR-së lidhur me të gjitha rastet e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuar dhe të referuara në bazë të këtij mekanizmi në përputhje me PSV-të.

5 Kërkesë drejtuar Ministrisë së Brendshme 2019, Avokati i Popullit: Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës:

<https://avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Rekomandohet%20p%C3%ABmir%C3%ABsimi%20i%20m%C3%ABtejsht%C3%ABm%20i%20kushteve%20dhe%20i%20trajtimin%20t%C3%AB%20azilk%C3%ABrkuesve%20n%C3%AB%20Qendr%C3%ABn%20Komb%C3%ABtare%20Prit%C3%ABse%20p%C3%ABr%20Azilk%C3%ABrkuesit%20Babrru,%20Tiran%C3%AB.pdf>

6 Porta Vendore, masat e bashkive në kuadër të pandemisë: <https://portavendore.al/2020/04/30/si-kane-reaguar-bashkite-per-situaten-masat-dhe-shpenzimet-e-bashkive-gjate-COVID-19/>

Autoriteti Përgjegjës me Udhëzimin e përbashkët nr. 3799, datë 27.07.2014 “Për Ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për Identifikimin, Referimin, Mbrojtjen dhe Ri-integrimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit,”⁷ u zgjerua me anëtarë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Shëndetësisë, Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik, si dhe funksionon dhe organizon takime të rregullta ku trajton çdo rast të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Megjithatë është konstatuar se ende nuk kemi të botuar apo pasqyruar gjatë periudhës së pandemisë vendime apo strategji afatshkurtra apo afatmesme për trajtimin e të trafikuarve sipas nevojave dhe mbështetjes që nevojitet për shkak të COVID-19.

Një problematikë evidentohet nga ana e organeve përgjegjëse pranë Ministrisë së Brendshme, ku evidentohet se për një kohë të gjatë nuk janë mbledhur strukturat përkatëse për të ngritur problematika apo ofruar zgjidhje për situatën e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri duke konsideruar faktin se ky autoritet drejton Komitetin Shtetëror për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Zv. Ministri i Brendshëm mban detyrën e Koordinatorit Kombëtar të masave dhe luftës antitrafik në rang vendi.

Duke konsideruar faktin se ky Komitet ka kompetencë të hartojë, monitorojë dhe zbatojë politika në fushën kundër trafikimit, nevojitet që të hartohet një plan veprimi afatmesëm me masa adekuate për të përballuar problematikat e reja të kësaj shtrese shoqërore.

Kapitulli IV.

Problematikat e evidentuara nga anketimi me viktimat e trafikimit pranë qendrave të akomodimit të tyre dhe rekomandimet përkatëse

Me qëllimin për të patur një situatë sa më konkrete dhe të prekshme mbi përjetimet e drejtpërdrejta mbi situatën e pandemisë ndaj subjekteve të përmendura në këtë raport, është paraparë e rëndësishme që kontaktimi i drejtpërdrejtë me ta të ishte një nga mënyrat më efektive për të identifikuar problematikat e tyre dhe propozimet konkrete për përmirësimin e situatës.

Qendra ALTRI ka realizuar një anketim në strehëzat e trajtimit të personave të trafikuar në qytetet e Tiranës, Vlorës dhe Elbasanit, si dhe ka marrë prononcime edhe nga përfaqësues të organeve vendore të këtyre qyteteve lidhur me situatën e trajtimit të viktimave të trafikimit dhe problematikave që shoqërojnë këtë veprimtari.

Në strehëzat “*Vatra*” në Vlorë, “*Tjetër Vizion*” në Elbasan, “*Të ndryshëm, të barabartë*” dhe Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit në Tiranë, viktimat e trafikimit të intervistuar ngritën shqetësimin për situatën që po kalojnë nga pandemia COVID 19, ku shumica e tyre deklaruan se kanë humbur punën ose e vijnë atë me kohë të pjesshme, duke mos realizuar plotësisht të ardhurat për jetesë dhe për plotësimin e nevojave të tjera.

Problematika të tjera të referuara nga viktimat e trafikimit, konsistojnë në mungesën e pajisjeve mbrojtëse dhe detergjentëve për të mbajtur nën kontroll higjienën e tyre ndaj pandemisë. Ato kanë ngritur shqetësimin se komunikimet online për shkollimin e fëmijëve, këshillimin e tyre të vazhdueshëm nga organet vendore, kërkimin për një vend të ri pune, janë kryer rrallë dhe me shumë vështirësi.

⁷ Udhëzim i përbashkët nr. 3799, datë 27.07.2014: <https://mb.gov.al/wpcontent/uploads/2019/12/PROCEDURAT-STANDAR-DE-T%C3%8B-VEPRIMIT-PER-MBROJTJEN-E-VIKTIMAVE-TE-TRAFIKIMIT.pdf>

Viktimat e trafikimit kanë ngritur gjithashtu shqetësimin se janë reduktuar në maksimum aktivitetet psiko-sociale dhe ato në natyrë. Po ashtu ato ndjehen të rrezikuara që për shkak të humbjes së punës të humbasin edhe qeratat e shtëpive, duke mos përfituar bonuset nga organet vendore.

Distanca për shkak të COVID-19 dhe mungesa e linjave të dedikuara online, i ka krijuar viktimave të trafikimit shumë vështirësi për tu lidhur me familjarët e tyre dhe lëvizja për ti takuar ata ka qenë pothuajse e pamundur. Po ashtu ato ndjehen të rrezikuara sepse nuk kanë marrë informacione të shtuara praktike nga qendrat shëndetësore se si të mbrohen për tu mos u prekur nga COVID-19.

Viktimat e trafikimit kanë pretenduar se për shkak të kufizimeve janë anuluar edhe oraret e takimeve me përfaqësues të organeve vendore, lidhur me nevojat e tyre për tu këshilluar dhe për të marrë shërbime. Gjithashtu, është ngritur shqetësimi se për shkak të mbipopullimit në dhoma, duhet të këtë një vëmendje me të madhe të organeve shëndetësore, duke ju bërë në mënyrë periodike testet serologjike. Si pretendime të tjera është parashtruar edhe nevoja për të rishikuar rregulloret e Strehëzave, duke i përputhur ato me protokollet e reja anti-COVID me qëllimin për të shmangur sa të jetë e mundur veprimtaritë e përbashkëta që mund të rrezikojnë shëndetin e tyre për shkak të pandemisë.

Personat e anketuar kanë hedhur mendime edhe për fushata të ndryshme që duhet të iniciohen për të sensibilizuar problematikat e tyre, ku në veçanti zinin vend mbështetja për fëmijët, plotësimi i nevojave të përditshme, punësimi, mbulimi i shpenzimeve të shtuara financiare etj.

Nga kryqëzimi i të dhënave të mbledhura nga anketimi i këtyre qendrave, vihet re se ato kanë të përbashkëta problematikat e strehimit, punësimit, aktiviteteve sociale, kontakteve me familjarët, ofrimit të shërbimeve publike nga administrata vendore, mbështetjen me medikamente, shërbim psiko-social, edukim dhe arsim për fëmijët dhe gjithashtu për akses të pandërprerë në internet.

Nga ana tjetër, intervistimi i Qendrës ALTRI përfshiu edhe përfaqësues të institucioneve vendore, të cilët u prononcuan mbi problematikat aktuale që kalojnë shërbimet ndaj personave të trafikuar. Në deklaratimet e tyre ata u ndalën fillimisht në situatën e pandemisë, duke pretenduar se ajo i ka gjetur të papërgatitur si në masa apo rregullore specifike, ashtu dhe në planifikimin e shpenzimeve të reja shpesh që u diktuan nga kjo situatë.

Megjithatë janë munduar të rifillojnë me organizimin e klasave të vogla online, përgatitjen e një kalendari për takime dhe këshillime të tjera online, si dhe shtimin e komunikimeve për të qenë sa më të informuar për problematikat e personave që janë të akomoduar në strehëzat përkatëse. Ndër masat që ndihen të nevojshme për tu realizuar nga ana e organeve vendore dhe të evidentuara edhe nga anketimi me përfaqësuesit e tyre, ishin shtimi i fondeve financiare, pajisjeve të komunikimit online, hartimi i programeve të reja për këshillimin dhe edukimin në distancë, miratimi i metodave të reja për ndjekjen psiko-sociale të personave në qendrat e akomodimit, mbështetja me masa mbrojtëse apo solucione të tjera dezinfektuese.

Të gjitha këto masa, të cilat sipas përfaqësuesve vendore po viheshin në zbatim në kuadër të një strategjie të re anti-COVID, kishin nevojë sipas tyre që të shoqëroheshin edhe me një fushatë sensibilizuese të organizuar në bashkëpunim me shoqërinë civile, ku të evidentoheshin problematikat e personave të akomoduar në qendra dhe të nxitej shtimi i vëmendjes ndaj trajtimit të tyre, e lidhur veçanërisht me përballimin e nevojave anti-COVID. Kjo do të sillte një trajtim më gjithëpërfshirës dhe një vizibilitet më të lartë ndaj kushteve dhe plotësimit të nevojave të personave të trafikuar për të shmangur pabarazinë e kushteve dhe për të krijuar një klimë pozitive kohezioni social.

Rekomandime

Në bazë të rekomandimeve dhe analizave të raporteve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke analizuar dhe gjetjet apo konstatimet e përfuara nga intervistat e viktimave të trafikimit, por edhe në sajë të bashkëpunimit me organet vendore, qendrat e strehimit të viktimave të trafikimit dhe OJF të ndryshme që kanë si objekt përmirësimin e situatës së viktimave të trafikimit, u konkluduan rekomandimet e mëposhtme në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve ndaj viktimave të trafikimit në kohë pandemie:

- Të intensifikohet bashkëpunimi midis OJF-ve dhe organeve vendore në shtimin e masave mbështetëse psiko-sociale dhe shëndetësore në qendrat e pritjes/strehëzat dhe ndaj personave të trafikuar;
- Të krijohet mundësi për aktivitete sociale, akses në internet, mbështetje psikologjike gjatë periudhës së pandemisë;
- Të organizohen takimet me institucionet vendore për të marrë vendime apo ngritur propozime pranë qeverisë në shtimin e fondeve dhe përmirësimin e kushteve të trajtimit të personave të trafikuar me privilegjet që ju takojnë për shkak të statusit të tyre ligjor;
- Mbajtja nga organet vendore në monitorim dhe me mbështetje të vazhdueshme të familjeve, duke i mbështetur me masa sociale, materiale dhe edukative;
- Rritjen e masave koordinuese midis sistemit parashkollor, shkollave 9 vjeçare dhe të mesme, për të realizuar mësimin *online* në mënyrë të garantuar ndaj personave të trafikuar që jetojnë në qendrat pritëse;
- Shtimin e numrit të psikologëve dhe punonjësve social në sistemin parashkollor, qendrat pritëse dhe sistemin shkollor për monitorim më të mirë të fëmijëve në risk për trafikim, duke ju nënshtruar trajnimeve të vazhdueshme në këtë fushë;
- Riorganizimin dhe shtimin e personelit të organeve vendore dhe njësisve rajonale antitrafik, duke rritur kujdesin dhe monitorimin për personat në kushte të vështira ekonomike me risk të lartë ri-trafikimi;
- Mbështetje më të madhe të shoqërisë civile me fonde të veçanta dhe akreditimin si pjesë e veprimtarisë antitrafik nëpërmjet publikimit të të dhënave të tyre në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme;
- Hartimin e një ligji të ri që të rregullojë përfundimisht statusin e institucioneve antitrafik dhe kompetencat e tyre, duke përqëndruar kompetencat dhe duke ju deleguar attribute për të marrë vendime me karakter emergjent në kohë pandemie ndaj subjekteve që trajtojnë;

- Shtimin e fondeve mbështetëse për të trajtuar sa më shumë viktime të trafikut në qendrat pritëse, duke ju ofruar të gjitha llojet e shërbimit psiko-social dhe shëndetësor;
- Shtimin e fondeve, financimin dhe koordinimin akoma më të madh me shoqërinë civile për të ngritur dhe plotësuar të gjitha standardet pritëse në qendrat që ato administrojnë;
- Përmirësimin e procedurave për mbështetje gjatë procesit të drejtësisë penale, duke u dhënë viktimave periudhë të plotë reflektimi, mbështetje gjatë proceseve ligjore dhe ndihmë për të kërkuar kompensim/dëmshpërblim;
- Të plotësohet Qendra Kombëtare e Pritjes së Azilkërkuesve me të gjitha shërbimet dhe burimet njerëzore të specializuara për të ofruar shërbimin e duhur dhe sipas standardeve;
- Të rishikohen normat ushqimore, në veshmbathje dhe në ambientet për jetesë të azilkërkuesve dhe të viktimave të trafikimit në veçanti për të plotësuar nevojat optimale ndaj tyre;
- Të sigurohet që viktimat e trafikimit të jenë të informuar sistematikisht për të drejtën e tyre.

“Masat për Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore si dhe Parandalimin e Përhapjes së COVID-19 në Strehëzat ku Strehohen Viktimat dhe Viktimat Potenciale të Trafikimit”. Ky projekt zbatohet nga Qendra ALTRI me mbështetjen e Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ).”



Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

